



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-16396 /22

Klinë, dt: 20.05 /22

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 15.04.2022, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e komitetit, drejtorët dhe gjithë të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

-Kryesuesi theksoi se të gjithë janë prezent dhe mund të fillojë me punë. Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit finansiar për tremujorin e parë 2022,
4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Mars - Prill 2022,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi debat rreth rendit të ditës. Pasi të gjithë u dakorduan për rend dite, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës.

Me 7 vota PËR, u MIRATUA Rendi i Ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Z.Fadil Gashi, Kryesues: Të gjithë anëtarët e Komitetit janë prezent.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Z. Fadil Gashi, Kryesues: Nëse ka dikush diçka rreth procesverbalit nga seanca e kaluar urdhëroni, unë po hapi debat!

-Pasi nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, u MIRATUA procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i raportit finanziar për tremujorin e parë 2022.

Z. Fadil Gashi, Kryesues: Ashtu siç e dini edhe ju, kjo është një kërkesë ligjore, po ashtu në çdo tre muaj shqyrtojmë raportet financiare ashtu siç parashihet me ligj. Ne mund ta diskutojmë së bashku nëse do të ketë ndonjë vërejtje apo sugjerim, por në fund duhet ta rekomandojmë për kuvend ku edhe aty do të debatohet.

Unë po hapi debat, nëse ka dikush diçka, urdhëroni!

Z.Tunë Dedaj: Mendoj se ne duhet ta rekomandojmë për Kuvend dhe aty do të diskutohet, unë nuk kam diçka tjetër.

-Pasi askush nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që raporti finanziar për tremujorin e parë të vitit 2022 të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Mars - Prill 2022.

Z. Fadil Gashi, Kryesues: Unë po filloj me prezantimin e kërkesave, ashtu siç na kanë ardhur për shqyrtim.

Kërkesa 1.

Kërkesë e parashtruar nga z. Alija Bikaku, për lejimin për shfrytëzim pa afat të caktuar, pronën e paluajtshme të Komunës së Klinës në sipërfaqe prej **2046m² (20.46 ari)** e cila është pjesë e parcelës me numër. P- 71011007-00138-0 ZK Bokshiq. Po ashtu, thekson se këtë pronë e shfrytëzon vite me radhë dhe se kjo sipërfaqe ka qenë e paraardhësve të tyre.

Ne të gjithë e dimë se si është procedura për dhënie në shfrytëzim të pronës shoqërore, por unë po hapi debat!

Z.Tunë Dedaj: Mendoj se është mirë që këto kërkesa të adresohen aty ku parashihet sipas ligjit dhe të jepen ashtu siç e parashevligji.

Z. Fadil Gashi, Kryesues: Të them të drejtën këto janë në adresë të saktë, sepse në Kuvend merret vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës më shumë se një vit. Por paraprakisht listën e pronave, të cilat mendohet të jepen në shfrytëzim, duhet të na vijë nga ekzekutivi dhe ajo paraprakisht duhet të miratohet në kuvend siç e kemi miratuar listën e pronave (banesave dhe

lokaleve), pastaj ato prona mund të jepen pas përfundimit të procedurave tjera. Nëse edhe ju pajtoheni që edhe kjo kërkesë të trajtohet ashtu siç i kemi trajtuar kërkesat e kësaj natyre.

Pas përfundimit të debatit rrëth kësaj kërkesë, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kjo kërkesë të kalojë për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe në drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, të kompletohet si lëndë duke respektuar Ligjin Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës dhe pastaj të vijë në Kuvend.

Kryesuesi vazhdoj me prezantimin e kërkesave:

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Vasa Doqaj, e cila thekson se vuani nga një sëmundje e rëndë (Kancer) dhe po ashtu nga një sëmundje tjetër mendore dhe depresive. Prandaj, nuk jam e aftë të punoj, duke marr parasysh se trajtimi i sëmundjeve ka kosto të lartë financiare nuk mund të mbuloj shpenzimet me buxhet familjarë, për këtë arsyesh kërkoj ndihmë financiare. Kryesuesi hapi debat!

Z.Tunë Dedaj: Duke e parë që qeveria nuk po merr masa për sigurimet shëndetësore, prandaj qytetarët po detyrohen të kërkojnë ndihmë nga Kuvendi i Komunës dhe nga Komiteti, mendoj se kjo kërkesë duhet të dërgohet në Zyrën e Kryetarit për shqyrtim dhe Kryetari aq sa ka mundësi ta ndihmojë nga subvencionet.

Pas përfundimit të debatit, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe ti ndihmohet sipas mundësive buxhetore.

Kërkesa 3.

Kërkesë e parashtruar nga z. Gjon Berisha, për këmbim të pronës, i cili është pronar faktik i njësisë kadastrale me nr. 00235-12 Z.K Klinë, me sipërfaqe prej **101 m²** parcelë në të cilën është shtruar një asfalt për rregullimin e rrugës për banorët e lagjes. Andaj, kërkon që kjo sipërfaqe t'i kompensohet me ngastrën nr. 00235-4 Z.K. Klinë në sipërfaqe prej **56 m²** dhe ngastrën me nr. 00241-0 Z.K. Klinë në sipërfaqe prej **35 m²** që të dyja këto janë pronë shoqërore në emër të Komunës së Klinës të cilat janë të ngjitura me parcelën e pronarit.

Z.Tunë Dedaj: Mendoj se duhet ti bëhet një zgjidhje dhe t'i kompensohet prona. Por, qytetarët duhen të janë të gjuar që ju është rregulluar rruga pikë së pari. Unë personalisht kur është rregulluar rruga në Deiq, e kam dhënë një prej një ari e gjysmë, të cilën e kam blerë njëmijepesëqind euro dhe s'kam kërkuar kompensim. Pra, mendoj se kur interesit është i përgjithshëm, duhet Kuvendi të gjejë formë për kompensim.

Z. Fadil Gashi, Kryesues: Unë pajtohem me ty, Tunë, por paraprakisht është dashur të kenë marrëveshje me shkrim. Procedurat për këmbim sipas kërkesës ligjore i nis Kryetari, pra, ajo pronë duhet të jetë në listë e cila miratohet në Kuvend. Ne kemi vullnet të gjithë që ta ndihmojmë dhe të gjejmë një zgjidhje por që duhet ta respektojmë procedurën ligjore. Mendoj se është mirë që kjo kërkesë të dërgohet në drejtorinë e Urbanizmit dhe Zyrën e Kryetarit, që të shikohen të gjitha mundësitë për procedurën e këmbimit të kësaj prone.

Pas përfundimit të debatit, Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kjo kërkesë të kalojë për shqyrtim në Zyrën e Kryetarit dhe në drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, të kompletohet si lëndë duke respektuar Ligjin Nr.06./L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe pastaj të vijë në Kuvend.

Pika 5. Të ndryshme.

Z. Fadil Gashi, Kryesues: Nëse ka dikush diçka për të shtuar, urdhëroni!

Znj. Valmira Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Ne grapi parlamentar i LVV-së e kemi bërë një kërkesë për rend dite për seancë, prandaj kërkojmë që të jetë pikë e rendit të ditës për seancën e ardhshme ajo kërkesë.

Z. Fadil Gashi, Kryesues: Po, faleminderit! Kërkesa e juaj do të merret parasysh dhe do ta vendosim si pikë në rend të ditës për Kuvend. Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar, unë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, me kaq po e mbylli mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Procesmbajtësi,
Ahmet Berisha



Kryesuesi,
Fadil Gashi

